



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në vazhdimin e seancës së 89-të, të mbajtur më 20.07.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12 -3657/1 të datës 12.04.2022, me pretendime për parregullsi të mundshme në procedurën për furnizime publike të ----- Shkup, **HIDHET POSHT..**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, nuk ka elemente për veprim kompetent ndaj lëndës.

Lënda me numër 12 -3657/1 të datës 12.04.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të KSHPK-së- brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Më 12 prill 2022, një parashtrues i njohur ka dorëzuar një njoftim për veprime të mëtejshme, i regjistruar me numër 12-3657/1, datë 12.04.2022, pas së cilës është ngritur një çështje në lidhje me informacionin pas një denoncimi të paraqitur kundër ----- Shkup. Në rastin konkret bëhet fjalë për një pyetje të bërë me datë 28.03.2022 në Byronë e Prokurimit Publik nga një person juridik ----- në cilësinë e operatorit ekonomik, pra denoncim për parregullsi të mundshme në procedurën e prokurimit publik të autoritetit kontraktor ----- Shkup, në lidhje me dokumentacionin e tenderit për blerjen e shërbimeve të akomodimit në hotele me numër të shpalljes -----.

Gjatë shqyrtimit të denoncimit, KSHPK-ja ka kryer kontrole në SEPP, nga ku është konstatuar se në procedurën lëndore për prokurim publik më datë 22.03.2022, është lidhur marrëveshje me një operator tjetër ekonomik, dhe person juridik ----- nuk figuron fare si një ofertues, gjegjësisht nuk figuron si operator ekonomik i cili ka paraqitur ofertë në procedurën e caktuar për prokurim publik. Në të njëjtën kohë, në lidhje me përzgjedhjen e ofertës më të favorshme, nuk ka pasur ankesë nga asnjë operator ekonomik.

Nga sa u tha më lart, KSHPK-ja konstatoi se në rastin në fjalë nuk ka elemente për veprim kompetent dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**
Kryetar,

Biljana Ivanovska

Dorëzuar:

- Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: J.C,

Miratoi: Mr. V.G, anëtar i KSHPK-së

